

ANA LALAJ

NGJASHMËRI DHE PANGJASHMËRI NË LËVIZJET E 1968-s

**(Një vështrim krahasues me demonstratat e shqiptarëve
në Prishtinë, Tetovë dhe Shqipëri)**

Kjo vjeshtë shënoi 50 vjet që kur miliona protestues, kryesisht të rinj, nxënës e studentë, u ngritën në protesta së paku në tre kontinente, nga njëra anë në anën tjetër të Globit, nga Kalifornia e Meksika e deri në Lindjen e Largët duke tronditur qeveri dhe sisteme politike gjithandej nëpër botë. Përsa i përket protestave të 1968-s në Prishtinë, Tetovë etj., ajo që jemi mësuar të dëgjojmë mjaft shpesh, deri më sot, është se ato nuk kanë pasur lidhje me të ngjashmet e tyre në të njëjtin vit në metropolet e Perëndimit e të Lindjes. Ka mjaft arsye për t'u mbajtur tek një përfundim i këtillë, përderisa thelbi i protestave (më saktë, qëllimi i tyre) ishte vërtet specifik, në raport me protestat e tjera të të njëjtës kohë, si në Perëndim, ashtu edhe në Lindje.

Gjithsesi, sot, pas gjysmë shekulli, kur ngjarjet e 68-s janë marrë e rimarrë në vëzhgime e studime pa fund, kur pas gjysmë shekulli kanë ndodhur kapërcime të mëdha shoqërore në rrafsh global, kur në trevat shqiptare kanë ndodhur po ashtu zhvillime të mëdha, sot, pra, na duhet të shohim se 68-a shqiptare, më së pari *si qasje studimore*, nuk është aq e palidhur me kohën e saj dhe, mbi të gjitha, *në plan kombëtar* ka gjasa që tek 68-a të gjejmë tharmin e të sotmes. Ky artikull ka për objekt sa ta cekë këtë bashkëlidhje, aq sa është e mundur në hapësirën që ai lejon.

Ata që janë marrë me historinë dhe zhvillimet sociale e politike të viteve '60, janë rrekur të identifikojnë burimet prej nga u ushqyen lëvizjet politike të këtyre viteve e që kulmuan më 1968. Nga bibliografia e këshilluar del se burimet kanë qenë komplekse. Nisur nga një pjesë e ngjashme, sidomos po t'i grupojmë këto lëvizje veçmas në Perëndim e veçmas në Lindje, të shumtët e shkaqeve kanë qenë të veçanta nga një vend në një tjetër, sipas rrethanave historiko-sociale apo situatave të krijuara në çdonjërin prej këtyre vendeve. Po ashtu, mjaft nga autorët, të cilët unë i përmend në këtë punim kanë vërejtur se lëvizjet politike, trazirat i gjetën kudo autoritetet të papërgatitura, pasi ato erdhën të befasishme. Që këtej është folur për situata të mbarsura, duke u shtruar

pyetja si ndodhi të jenë krijuar akumulime të asaj shkalle, sa sollën tronditje të papritura e për më tepër të përqendruara në kohë dhe me shtrirje thuajse të përbotshme? Aq sa, siç thotë historiani i njohur Erik Hobsbawm, “nëse ka një moment të vetëm në vitet e arta pas 1945-s, që përkon me përmbysjen e njëkohshme për të cilën patën ëndërruar revolucionarët pas vitit 1917, ai është me siguri 1968-a...”¹

Në kërkim të rrethanave burimore, si shkaqe për trazira, autorë të ndryshëm u janë drejtuar programeve zhvillimore të pasluftës së Dytë Botërore, por kanë folur edhe për polarizimet shoqërore, kanë trajtuar bindshëm përplasjet mes dy kampeve dhe konfliktet midis të Mëdhenjve, ashtu siç kanë shpjeguar efektet e detantave, paqëtuese për stabilitetin ndërkombëtar, por me kosto në progresin e brendshëm. Në 15 vjet u shënuan arritje të rëndësishme, madje historike për njerëzimin, siç është regjistruar dalja në orbitë e rusit Gagarin. Transformimet qenë të ndjeshme edhe në plan kulturor e shpirtëror. Në Perëndim, që prej fundit të luftës, numri i studentëve u tre ose katërfishua. Në Bllokun Lindor, po ashtu, arsimimi i rinisë ishte përparësor në politikën qeverisëse. Më shumë se aq, me ardhjen e Hrushovit në pushtet, në Bllok u ndje një farë liberalizimi në jetën shoqërore. Në Perëndim, miliona të rinj u përfshinë si konsumatorë të prurjeve më të reja kulturore, sidomos të grupeve muzikore. Ndërsa në Lindje, shkrimtarë në zë, po tërhiqnin vëmendjen me disidencën e tyre artistike. Ndoshta ky stad zhvillimor ishte arsyeja që liderë botërorë dolën para kombeve të tyre me ambicie të mëdha. Ndër më kryesorët, ishte Kenedi ai që premtoi zgjerime të kufijve të ndikimit të Shteteve të Bashkuara kundër komunizmit, ishte Hrushovi që premtoi komunizmin real, De Goli që do t'i kthente madhështinë Francës dhe, më në fund, Mao që do të udhëhiqte Kinën në Hopin e Madh Industrial dhe do t'ia kalonte Evropës.²

Megjithatë në mesin e viteve '60 gjendja nuk ishte aq rozë dhe në çdonjërin prej këtyre vendeve u ndje rreziku i dhunës së brendshme, përjashtuar republikave sovjetike, ku pas rënies së Hrushovit qe kthyer hija e Stalinit. Si subjekte të dhunës u identifikuan kryesisht të rinjtë dhe sidomos rinia universitare. Pikërisht ajo shtresë sociale që ishte konsumatorja më e madhe e lirive. Nga të parët që u ngritën në protesta

¹ Eric Hobsbawm, *Epoka e ekstremeve, i rrëmbyeri shekull i njëzetë, 1914-1991*, përkthim shqip nga Daut Gumeni, Tiranë: Çabej, 1997, f. 252.

² Jeremi Suri, *Power and Protest (Global Revolution and the Rise of Détente)*, Harvard University Press, Cambridge, Massachusetts, and London, England: 2003, p. 260.

qenë studentët e Berkley-t, një universitet me emër në Kaliforni. Është koha kur Amerika specifikisht po përjetonte një lëvizje të gjerë për të drejtat civile dhe studentët ishin mbështetësit e saj me “Lëvizjen për Fjalën e Lirë” (“Free Speech Movement”). Lëvizja u përshkallëzua në marshime proteste kundër luftës. Në tetor 1965, më shumë se 50 mijë vetë nga e gjithë Amerika udhëtuan në Washington D.C., në protestë kundër luftës në Vietnam. Madje, turma tentoi të rrethonte Pentagonin. Një lëvizje studentësh kjo, që filloi me pakënaqësitë ndaj autoriteteve të universitetit, e që u shndërrua në një lëvizje turmash të dhunshme kundër qeverisë. Aq sa: “Në fund të mandatit të tij, më 1968, Xhonsoni nuk mund të shfaqej në publik, veçse në bazat ushtarake, ... ai nuk mundi, madje, të shfaqej as edhe në konferencën e partisë së vet, më 1968.”³

Për të ardhur në Evropë, një autor tjetër, Walter Laqueur (Uolltër Lakër) thotë se fillimvitet '60 kishin qenë të qeta dhe revoltat e studentëve kishin zgjuar habinë e të gjithëve. Në Paris, gjithçka filloi me një grevë studentësh dhe pedagogësh në një universitet të periferisë, në nëntor 1967 dhe u pasua me protesta në universitetet e tjera. Ndërhyrjet e ashpra të policisë dhe mbyllja e auditorëve i acaruan edhe më keq studentët. Por protestat u bënë të frikshme, kur ato i morën në dorë grupe ekstremistësh të majtë dhe në maj 1968, dolën në rrugë me sloganin “Liri”, me të cilën synonin të thyenin zinxhirët e shoqërisë së vjetër, e cila refuzonte t'i quante studentët si individë të rritur e të pjekur; ndërkohë me studentët u bashkuan disa milionë punëtorë. “Ajo që kishte nisur si diçka e rastësishme ishte kthyer në sfidën më të madhe që kishte ndeshur ndonjëherë regjimi.”⁴ Thuhet, se pasi mori siguri për të përdorur ushtrinë, De Goli doli në një sekuencë të shkurtër televizive, ku njoftoi shpërndarjen e Asamblesë Kombëtare dhe mbajtjen e zgjedhjeve pas tri javësh, më 23 qershor 1968. Me këtë rast ai u bëri thirrje francezëve për veprim qytetar në mbrojtje të Republikës nga kërcënimi i diktaturës komuniste. Brenda disa minutave, një milion përkrahës, që thërrisnin “Franca francezëve” dhe këndonin Marsejezën, mbushën rrugët e Parisit në një marshim drejt Sheshit Konkord.⁵ Karizma e gjeneralit pati efekte magjie. Miliona francezë lanë barrikadat dhe në pak orë iu kthyen jetës

³ Henry Kissinger, *Diplomacia*, përktheu nga origjinali Petraq Pojani, Tiranë: Shtëpia Botuese e Lidhjes së Shkrimtarëve, 1999, f. 675.

⁴ Walter Laqueur, *Evrope in Our Time, A History, 1945-1992*, Penguin Books USA Inc: 1993, p. 347.

⁵ *Po aty*, p. 348.

normale. Qindra studiues janë rrekur e rreken të gjejnë motivet, pra *si-të* dhe *pse-të* e atyre revoltave të papritura që përfshinë botën dhe kulmuan në Paris. Por, me sa di, pakkush është marrë me çudinë si ato u mbyllën.

“Maji ’68 i Parisit” është kthyer në një çast kohor përfaqësues për revoltat e viteve 1967 – 68. Nuk ka dyshim që revoltat në Paris janë ndikuar dhe kanë ndikuar në lëvizjet e ngjashme në Perëndim dhe në Lindje. Por jo më shumë se aq. Ajo, që unë mendoj, është se në përgjithësi lëvizjet e 1967 – 68 *nuk kanë prodhuar njëra – tjetrën, ato bashkërisht janë produkt i rrethanave të ngjashme, ku u ndodh shoqëria e kohës. Veç të tjerash, protestat e studentëve në disa prej vendeve, kanë ndodhur më parë se në Francë. Për shembull, Berlioni Perëndimor u përfshi nga protestat më 1967. Në Romë, studentët qenë ngritur edhe më shpejt, më 1966, dhe vitin pasues protestat kishin përfshirë gjithë Italinë. Edhe më herët, që më 1965, qenë ngritur të rinjtë në Spanjë, duke u artikulluar si lëvizje kundër diktaturës së Frankos, dhe, që më 1968 u përhapën në gjithë vendin. E plot shembuj të tjerë.*

Regjimet komuniste i kanë parë protestat si kërcënim për sundimin e tyre, madje protestat në rrugë edhe si mjet destruksioni. Prandaj, sa herë është tentuar për revolta, ato janë shtypur ashpër. Vende si Gjermania Lindore, Polonia dhe Hungaria kanë regjistruar përvoja të përgjakshme. Por, në ndërkohë që kishin kaluar dhjetë vjet nga përleshjet e fundit në Budapest, u paralajmërua rikthimi i tyre. Nëse në Perëndim, arritjet kulturore jo në shkallën e pritshme, dhe një lloj stagnimi i shoqërisë, po prodhonte gjithnjë e më shumë pakënaqësi, në Lindje ngecjet në sistem, sollën më shumë arbitraritet e dhunë të pushtetit.

Në Bllokun Lindor, serinë e protestave e hapën të parët studentët e Pragës. Çekosllovakia, vendi me traditat më demokratike në Lindje, nën drejtimin e Antony Novotnit* kishte bërë hapa prapa. Po kështu ekonomia ishte përkeqësuar dhe në forumet drejtuese të partisë qenë shfaqur përplasjet, madje edhe etnike, midis çekëve dhe sllovakëve. Në fund të tetorit 1967, pesë mijë studentë të Universitetit Charles, (*Karlova Univerzita v Praze*) të themeluar në Pragë, në vitin 1348, protestuan për

* *Antoni Novotny* (1904-1975). Sekretar i Parë i Partisë Komuniste të Çekosllovakisë, 1953 - janar 1968; President i Republikës Socialiste të Çekosllovakisë, nëntor 1957 - mars 1968.

kushte më të mira jetese në konvikte.⁶ Policia ndërhyri duke përdorur edhe gaz lotsjellës. Ambasada shqiptare në Çekosllovakia e informonte Tiranën rregullisht për çfarë po ndodhte në Pragë, megjithëse publikut shqiptar nuk iu dha asnjë njoftim. Ndërkohë në Partinë Komuniste të Çekosllovakisë (PKÇ) plasi sherri. Në dhjetor, atje vajti edhe Brezhnjevi, por nuk ia doli t'i qetësonte kundërshtarët e Novotnit, atëkohë Sekretar i Parë i PKÇ, i cili u zëvendësua me komunistin sllovak, Aleksandër Dubček. Më vonë u përhap një anekdotë për të treguar si Brezhnjevi e la Novotnin në baltë, kur në plenumin e partisë kishte thënë, duke mbledhur supet: “*Eto vashe djello**.”⁷ Disa muaj më pas, po ky Brezhnjevi e braktisi parimin e mosndërrhyrjes, kur Praga u vu nën pushtim.

Pas Pragës, shpërtheu në Varshavë. Siç e shpjegon studiuesi britanik Tony Kemp – Welch, pikënisje u bë drama e Adam Mickiewicz, “*Dziady*,” që do të thotë afërsisht “*Homazh për të vdekurit*,” vënë në skenë nga trupa e Teatrit të Madh të Varshavës dhe që publiku po e ndiqte me interes që prej nëntorit 1967. Drama e merrte temën nga shekulli XVIII-XIX, por gazeta “*Pravda*” botoi një shënim kritik për frymën antiruse të saj. Autoritetet vendosën ta ndalonin shfaqjen. Më 30 janar 1968, 300 spektatorët e fundit, pasi duartrokitën gjatë aktorët dhe hodhën thirrje kundër censurës, u grumbulluan tek përmendorja e Mickiewicz-it e dekoruan me lule dhe me flamurin kombëtar. Ngjarja u bë subjekt peticionesh drejtuar parlamentit dhe intervistash për shtypin e huaj, si dhe i konferencave të shkrimtarëve. Në këtë frymë, më 8 mars, dy mijë studentë të Varshavës protestuan në mbrojtje të lirisë akademike dhe të autonomisë universitare. Protestat u përhapën kudo në Poloni. Ndër të tjera, policia sekrete e Krakovit raportoi edhe thirrjen: “E gjithë Polonia pret Dubčekun e saj!”⁸

⁶ Paul Matthey, “1968: The Year of Two Student Springs-Czechoslovak and French Movements Compared”, fl.7. (May-2012). Tërhequr nga: <https://independent.academia.edu/PaulMatthey>.

* Kjo është puna juaj (rusisht).

⁷ Arkivi Qendror Shtetëror i Republikës së Shqipërisë (më tej: AQSH), Fondi (më tej: F.) 14/AP-Strukturë, viti (më tej: V.) 1968, lista (më tej: L.) 24, dosja (më tej: D.) 333, fl. 2-28. “Relacion mbi gjendjen në partinë komuniste dhe raportin e forcave politike në Çekosllovakia”, më 28 korrik 1968.

⁸ Tony Kemp-Welch, ‘To Hell with Sovereignty!': Poland and Prague Spring”, in *Eastern Europe in 1968, Responses to the Prague Spring and Warsaw Pact Invasion*, Palgrave Macmillan, 2018, p. 129.

Duket se në këtë rast një zinxhir protestash i janë referuar njëra-tjetrës. Filloi me studentët në Pragë. Pas tyre, por jo për shkak të tyre, në krye të partisë erdhi Dubçeku, i cili u pa si shpëtimtar. Dubçeku erdhi me një program reformash liberalizuese në parti, që hyri në historinë politike të komunizmit si “Pranvera e Pragës.” Ky projekt jetëshkurtër zgjoi mjaft shpresa, e për këtë arsye me emrin e sllovakut Aleksandër Dubček dolën në rrugë edhe studentët polakë. Pas polakëve, ishin studentët e Zagrebit e të Beogradit që u solidarizuan me moshatarët e tyre në Varshavë, Gdansk, Ljublin e kudo. Një njoftim i legatës shqiptare në Beograd, më 9 maj 1968, thotë:

“Nga të dhënat e ndryshme që kemi prej studentëve kosovarë dhe nga sa shkruan shtypi i vendit, rezulton se studentët e Zagrebit dhe të Beogradit po përgatiten për një demonstratë të përgjithshme kundër udhëheqjes titiste. Deri tani ata kanë manifestuar sinjalet e para të pakënaqësive të tyre, të cilat mund të përmenden:

a) Janë të pakënaqur pse udhëheqja e tyre nuk dërgoi në adresë të Ministrisë së Arsimit të Polonisë protestën e tyre kundër qeverisë polake lidhur me masat shtypëse, që ajo mori ndaj studentëve polakë. Në një mbledhje, që u organizua për këtë çështje në Zagreb shkoi e foli Mijalko Todorović, zëvendës Kryeministër i RSFJ, por, me sa rezulton, studentët e kanë sharë në prezencën e tij, duke i thënë se jeni person i paaftë dhe analfabet.

b) Ndërsa studentët e Beogradit duke u solidarizuar me protestën e studentëve të Zagrebit, ndërkohë kanë shprehur pakënaqësi lidhur me trajtimin e tyre. P.sh., studentët e Zagrebit marrin 35 mijë dinarë të vjetër bursë, ata të Serbisë marrin 24 mijë. Të tjerë kanë shprehur pakënaqësinë se pas mbarimit të shkollës mbeten pa punë etj. Për të qetësuar gjendjen, shkoi anëtari i kryesisë së LKJ Raif Dizdarević, por edhe ky pësoi fatin e Todorović-it. Përfundimisht del se studentët po përgatiten për një demonstratë të përgjithshme, qëllimi i të cilës do të jetë solidariteti me studentët e vendeve të tjera revizioniste, sidomos polakë dhe çekë, për liri më të mëdha demokratike dhe për kërkesa ekonomike. Kundër këtyre veprimeve klika titiste është duke marrë një sërë masash policeske, ajo po ushtron kontrole të forta në radhët e studentëve dhe po patrullon nëpër rrugët e qyteteve për të penguar demonstratat.”⁹

⁹ Arkivi i Ministrisë së Punëve të Jashtme të Republikës së Shqipërisë (më tej: AMPJ), viti (më tej: V.) 1968, dosja (më tej: D.) 360/1, fl. 39-42. Radiogram i deshifruar nr.

Nga njoftimi i mësipërm, duket se protestat e studentëve në Zagreb e Beograd, për nga motivet ndjekin linjën e protestave në Perëndim.

Ndryshe ndodhi me protestat në Pragë e Varshavë. Në Varshavë: kundër dhunës, kundër censurës, më shumë demokraci, liri akademike etj. Në Pragë: thirrjet për drita dhe ujë në konvikte ishin thjesht kopertura. Ndërmjet studentëve dhe pedagogëve të Universitetit *Charles*, kishte kohë që zhvillohej një dialog intensiv në kuadër të një “shoqërie intelektuale.” Pjesa më e madhe e profesorëve nuk ishte anëtarësuar në PKÇekoslloake, ndërsa studentët nën drejtimin e tyre përfaqësonin një lloj inteligjence të re, që ishte shumë e rëndësishme në sferën politike të Çekosllovakisë, në luftën për të arritur një “Socializëm me fytyrë njeriu” dhe prandaj, ky dialog konsiderohet një nga momentet kyç të ‘Pranverës Çekoslloake’.¹⁰ Ndër të tjera, studentët qarkullonin me njëri tjetrin fjalën e shkrimtarit Ludvig Vaculik në Kongresin e Katërt të Shkrimtarëve Çekosllovakë, mbajtur në qershor 1967. Vaculik ishte ngritur kundër partishmërisë në letërsi dhe ishte përkrahur nga Ivan Klima, Milan Kundera etj.¹¹ Në Pragë e Varshavë, pakënaqësia e studentëve e prekte regjimin në nerv, në mungesën e lirive dhe prandaj, protestat u shtypën me egërsi. Në Beograd, pakënaqësia vinte për pamjaftueshmëri reformash dhe Tito i mbylli protestat ashtu siç dinte ai, me dhelpëri. Pasi u përjashtuan disa studentë dhe pedagogë nga Lidhja Komuniste e Jugosllavisë, më 9 qershor 1968, Tito doli në Televizionin e Beogradit dhe studentët u shpërndanë për pushime. Kur ata u kthyen në vitin e ri akademik, çdo gjë kishte përfunduar.

Në Prishtinë, Pejë, Tetovë protestat u mbajtën atëherë kur gjithë të tjerët i kishin mbyllur. Për demonstratat në Kosovë e Maqedoni tanimë kanë folur jo pak studiues, duke na sjellë madje edhe hollësira, të cilat ndihmojnë sa herë merret e rimerret kjo temë. Bibliografia me të cilën unë jam këshilluar, librat e Adil Pirevës,^{*} Ethem Çekut^{**} dhe veçanërisht

383-386, datë 9.5.1968, i legatës së RPSH në Beograd për Ministrinë e Punëve të Jashtme, Tiranë.

¹⁰ P. Matthey, “1968: The Year of Two Student Springs ...”, f. 8.

¹¹ *AMPJ*, V. 1967, D. 17, fl. 76-78. Fondi i përkohshëm, radiogram i deshifruar nr. 870-872, datë 9.11.1967, i Ambasadës së RPSH në Pragë për Ministrinë e Punëve të Jashtme, Tiranë.

* Adil Pireva, *Gjashtëdhjetëta Shqiptare*, Prishtinë: Shtypshkronja DRUCK ART, 1994.

** Ethem Çeku, *Mendimi politik i Lëvizjes ilegale në Kosovë, 1945-1981*, Prishtinë: Brezi '81, 2003.

të Selatin Novosellës,^{***} dhe të tjerë, kanë fiksuar çaste dhe protagonistë, me aktet e tyre gjithherë të rivlerësueshëm, dëshmi përpjekjesh të mëdha për çështjen kombëtare të shqiptarëve. Kronika nis që më 6 tetor 1968 me demonstratat në Prizren, ku u kërkua për herë të parë republika e Kosovës; për të vazhduar në Therandë (dikur quhej Suharekë), më 8 tetor; në Pejë, më 19 tetor; për të kulmuar në Prishtinë, më 27 nëntor. Kronikat thonë se po atë ditë, më 27 nëntor, demonstrata pati edhe në Ferizaj, Gjilan, Besianë (dikur quhej Podujevë) e Mitrovicë dhe në mbyllje, më 22 e 23 dhjetor në Tetovë.

Nuk po shtyhem më tej në rrjedhën e ngjarjeve, pasi nuk disponoj të dhëna të tjera, përpos atyre që janë bërë të njohura. Ajo që dua të ndaj me lexuesin janë komentet për ngjarjet, si dhe disa të dhëna lidhur me perceptimin dhe qëndrimin zyrtar të Shqipërisë, të dhëna që gjenden në arkivat e Tiranës.

Pyetja më e parë që vjen për arsyen e protestave është: *Pse në Kosovë e pse ndër shqiptarët e Maqedonisë?* Arsyetimet të çojnë në rrjedhat historike të jetës së shqiptarëve, në diskriminimin e pandërprerë dhe fatet e tyre tragjike. Dhuna e shtrëngesa edukojnë shoqëri të bindura, në raport me regjimet. Por sa herë dhe gjithkund ku ka dhunë e shtrëngesë, e gjitha shoqërohet edhe me akumulime pakënaqësish, të cilat shpërthejnë sapo ta sjellë çasti i duhur.

Por le të marrim vetëm një tregues diskriminimi, shkollimin në gjuhën amtare. Inkuizicioni në këtë fushë ndaj shqiptarëve ka qenë i pashembullt. Pas Luftës së Parë Botërore shqiptarët jashtë kufijve londinezë e vuajtën edhe më shumë, sepse për ta pushtuesit e rinj, nëse nuk ishin inkuizitorë të mirëfilltë, ishin njësoj të paimterësuar për shkollimin e shqiptarëve në përgjithësi. Ndërsa për shkollimin shqip as që bëhej fjalë. Ishte një akt i jashtëzakonshëm ai i qeverisë së Mustafa Krujës dhe i ministrit të Arsimit, Ernest Koliqi, kur në verën e vitit 1941 mobilizuan dhjetëra mësues vullnetarë nga Jugu dhe Veriu i Shqipërisë për t'i dërguar në 'Tokat e Lirume,' në Kosovë e Maqedoni. Atë shtator në Kosovë u hapën 61 shkolla shqip dhe në Maqedoni 54 shkolla. Nga dokumentet që ka mbledhur dhe botuar në katër vëllime tejet të vlefshme, studiuesi i pasionuar Qerim Lita, gjejmë edhe këtë dokument që inspektori i arsimit i Tetovës ia dërgonte Ministrisë së Arsimit: "Në një

^{***} Selatin Novosella, *Demonstratat e Gjashtëdhjetetës*, vëll. 1, Monografi; vëll. 2. Dokumente; vëll. 3. Dokumente, Prishtinë: Shoqata e të burgosurve politikë, 2008.

vend si Tetova, thuhet në shkresë, ku në vatrë familjare vlon së foluri turqishtja, randësinë ma të madhe ia kemi dhanë gjuhës shqipe ... Me rastin e një manifestimi, që ka ba shkolla fillore e këtushme, kur thuheshin vjersha e deklamoheshin dialogje me ngjyrë kombëtare, gjindja mallëngjeheshin kaq tepër, sa prej gëzimit u shkojshin lotët.”¹²

Diçka u bë menjëherë pas luftës, kur qeveritë komuniste në të dyja vendet patën një program arsimimi. Pastaj u rikthye diskriminimi dhe përsëri disa hapa të ngadalshëm. Më 1966, në Kosovë mbi 50 mijë nxënës nuk i ndiqnin mësimet, pasi ose nuk kishte shkolla, ose për nevoja në familje.¹³ Në vitin 1982-'83, në Maqedoni u arrit që 97 për qind e nxënësve të ndiqnin arsimin e mesëm, dhe në këtë tregues, shqiptarët zinin vetëm 7 për qind.¹⁴ A nuk janë arsye këto për grumbullim pakënaqësish? Po t'i shtojmë kësaj prapambetjeje edhe diferencat e treguesve ekonomikë midis Kosovës dhe Jugosllavisë, midis Kosovës dhe Serbisë, po qe se do t'u riktheheshim shfarosjeve masive të rinisë shqiptare në fund të luftës, po t'u shtojmë më tej edhe torturat çnjerëzore në të famshmin aksion të mbledhjes së armëve, më 1955-'56, aq sa ka ndodhur që shqiptarët të jenë detyruar të blinin një armë ku të mundnin e t'ua dorëzonin oficerëve të UDB-së për t'u shpëtuar torturave;¹⁵ të gjitha këto janë burime të mëdha për pakënaqësi.

Duke përmendur diferencat diskriminuese deri në racizëm, për shqiptarët ishte e qartë se të gjitha këto vinin nga një pozitë e tyre juridike e pabarabartë me popujt e tjerë në Jugosllavi. Pikërisht për këtë arsye, ata e mendonin statusin e tyre juridik, çelësin e zgjidhjes të të gjitha problemeve. Statusi i barabartë me popujt e tjerë, ka qenë ëndërr për shqiptarët në Jugosllavi. Por, kur më 1 korrik 1966, Aleksandër Rankoviç, një armik i egër i shqiptarëve, ra nga pushteti, atëherë u ndje se për ta po frynin erëra të mbara. Që prej asaj kohe Tito inkurajoi reforma liberalizuese, sidomos në ekonomi, ashtu siç u përpoq të qetësojë

¹² *Tokat e Liruara, 1941-1944 (Përmbledhje dokumentesh)*, vëll. I, përgatitës Qerim Lita, Shkup, Prishtinë, Tiranë: Logos-A, 2016, Dok. 769, f. 270.

¹³ *AQSH*, F. 14/AP-Str., V. 1967, D. 255-1. “Raport i Universitetit të Tiranës për takimet me disa punonjës shkencorë nga Kosova”, 28 dhjetor 1967.

¹⁴ Tahir Zajazi, “Qasje analitike rreth arsimit dhe kulturës së shqiptarëve në trojet e veta etnike në Maqedoni”, në *Çështja e Kosovës – një problem historik dhe aktual*, Simpozium i mbajtur në Tiranë, më 15-16 prill 1993, botim i Institutit të Historisë Prishtinë dhe Institutit të Historisë Tiranë: 1996, f. 392.

¹⁵ “Mbledhja e Kuvendit Popullor të Kosovës-Metohisë”, *Rilindja*, Prishtinë, 14 nëntor 1966.

marrëdhëniet ndëretnike në Jugosllavi, sidomos ato midis serbëve dhe kroatëve. Këtij qëllimi i shërbeu reforma e re kushtetuese, një proces që filloi më 1967 dhe përfundoi më 1974. Pikërisht këtë moment e shfrytëzuan shqiptarët, kohë kur u nxitën më mirë, e më shumë se deri atëherë, si lëvizjet politike, ashtu edhe ato intelektuale. Siç do ta shohim më tej, ishte kjo klimë e favorshme ajo që mundësoi të shtroheshin lirshëm të gjitha opsionet, si dhe të mbroheshin ato.

Në mars 1967, Tito u premtoi kosovarëve, një Kosovë moderne. Në prill, qytetarët e Kosovës u thirrën të merrnin pjesë në diskutimet për amendamentet kushtetuese, një praktikë që nuk kishte ndodhur deri atëherë. Në korrik u krijua nga Kuvendi i Kosovës një “Komision për studimin e çështjeve që kanë të bëjnë me ndryshimet dhe plotësimet e statutit të Krahinës Autonome të Kosovës,” i quajtur shpesh dhe ‘Komisioni Kushtetues i Krahinës’. Komisioni lëshonte udhëzime dhe merrte propozimet që vinin nga individë, nga tubime të mbajtura për këtë qëllim, nga institucione etj. Në këtë proces, pjesëmarrja e qytetarëve ishte vërtet e lartë, çka shprehte shkallë maksimale vlerësimi. Pas një viti diskutimesh, Komisioni për ndryshime në statutin e Kosovës kishte mbërritur në një mendim të përbashkët që Krahina të kishte autonomi të plotë, që do të realizohej sidomos në çështjet ekonomike, në administratë dhe në sistemin gjyqësor. Po ashtu, sipas komisionit, përdorimi i simboleve kombëtare kërkohet jo vetëm të lihej i lirë për qytetarët, por të ishte edhe zyrtar.¹⁶ Legata shqiptare në Beograd, përmes shtypit dhe bashkëpunëtorëve të vet, i ka ndjekur me kujdes diskutimet. Ajo i raportonte Tiranës se çështja më e debatueshme dhe ku diskutimet ishin ndarë më tresh, ishte statusi i Krahinës. Në një radiogram të shtatorit 1968, thuhet se, nga një fjalim i Fadil Hoxhës* në Kryesinë e Këshillit të Lidhjes Socialiste për Krahinën, më 14 shtator, por dhe nga informacione të tjera, rezulton të ketë tri rryma. *Rryma e parë*, ku bën pjesë edhe Fadil Hoxha, si dhe zyrtarë të tjerë në organet krahinore ose federative, është për autonomi të plotë të krahinës. *Rryma e dytë*, ku bëjnë pjesë edhe shumë intelektualë, shprehet që Kosova të shkëputet nga Serbia si republikë më vete. Për argument ata sjellin rastet e dy Koreve, dy

¹⁶ “Drejt afirmimit të autonomisë, barazisë dhe unitetit të kombeve dhe të kombësive”, *Rilindja*, Prishtinë, 24 prill 1968.

* *Fadil Hoxha* (15 mars 1916 - 22 prill 2001). Një nga politikanët kryesorë të Kosovës, në vitin 1968 ishte Kryetar i Kuvendit të Krahinës Autonome të Kosovës dhe Metohisë.

Vietnamëve, dy Gjermanive. Ndërsa, *rryma e tretë*, ku bëjnë pjesë kryesisht përfaqësues të etnive serbe e malazeze, si dhe persona të njohur si përkrahës të Rankoviçit, kërkon që gjendja të mbetet e pandryshuar.¹⁷

Komisioni Kushtetues i Krahinës, mendimet e veta i shtroi për diskutime në aktivet politike, duke filluar nga Gjakova, gusht 1968, e më tej në Pejë, Deçan, Gjilan, Podujevë, Prizren etj. Në të gjitha aktivet u përkrah masivisht kërkesa për republikë. Duket se as në federatë, as në Republikën e Serbisë dhe as në komitetin krahinor, faktori politik nuk ishte i përgatitur për këto kërkesa, që çmoheshin maksimaliste. Në këto kushte, zyrtarë të niveleve të ndryshme u lëshuan nëpër komuna, institucione, improvizuan takime me ata që kishin më shumë ndikim tek njerëzit, duke u kërkuar atyre mbështetje për komisionin. Kjo gjë shkaktoi edhe irritime. “Kohët e fundit, thuhet në një radiogram të legatës së RPSH në Beograd, kanë filluar grindjet midis krerëve të Krahinës, nga njëra anë, dhe kryetarëve të komunave, nga ana tjetër. Këta të fundit akuzojnë të parët, pasi në fillim ata vetë e orientuan popullin e në mënyrë të veçantë inteligjencien, që me rastin e diskutimit të dispozitave të kushtetutës, populli kishte të drejtë t’i shfaqte lirisht mendimet e veta për vetëvendosjen. Mbështetur në këtë orientim, populli i Kosovës, e në mënyrë të veçantë inteligjencia, kërkoi që krahina të shpallet republikë. Është kjo arsyeja, vazhdon komentit i legatës shqiptare në Beograd, që inteligjencia nuk po tërhiqet nga kërkesat e saj të mësipërme, me gjithë presionet që po i bëhen asaj kohët e fundit nga krerët titistë të Krahinës dhe të Serbisë. Në ballë të kësaj lufte po qëndron Rezak Shala, i cili duke pasur mbështetjen e plotë të intelektualëve dhe studentëve akuzon Veli Devën dhe anëtarë të tjerë të Komitetit Krahinor të LK se një orientim të tillë e kanë dhënë vetë ata, gjë për të cilën kemi dokumente.”¹⁸

Fryma e diskutimeve, sa ç’ishte inkurajuese për shqiptarët e thjeshtë, aq edhe krijoi një lloj ankthi ndëretnik. Në radiogramin e mësipërm thuhej se “Aktualisht situata në Kosovë është keqësuar, sidomos mes studentëve shqiptarë dhe serbë e malazez. Ata, në asnjë vend nuk rrinë më bashkërisht. Një fenomen i tillë shihet në të gjitha qytetet ku ka shkollë të lartë, por më e theksuar është në Prishtinë. Këtu edhe rrugët e shëtitjeve i kanë të ndara, aq sa edhe qytetarët thonë se kjo rrugë është e

¹⁷ AMPJ, V. 1968, D. 360/1, fl. 91-94. Radiogram i deshifruar nr. 937-940, datë 23 shtator 1968, i legatës së RPSH në Beograd për Ministrinë e Jashtme.

¹⁸ *Po aty*, fl. 113-117. Radiogram i deshifruar nr. 1139-1143, datë 16 nëntor 1968, i legatës së RPSH në Beograd, drejtuar Ministrisë së Jashtme.

studentëve serbë, ndërsa rruga tjetër është e studentëve shqiptarë.”¹⁹ Në këtë situatë të mbarsur me tensione, Tito priti një përfaqësi nga Kosova. Në atë takim ai vuri vijën e kuqe, kur tha se “Republika nuk i zgjidhte të gjitha problemet”.²⁰ Këtu u mbyllën përpjekjet në rrugë legale për republikën. Për këtë arsye, studentët, por edhe qytetarë të tjerë dolën në rrugë.

Demonstratat në Prishtinë e pas tyre demonstratat në Tetovë u shtypën dhunshëm. Dy ditë më vonë, në 25-vjetorin e krijimit të Jugosllavisë Federative, Tito i dha mesazhet e veta nga Jajca, aty ku Këshilli Antifashist Nacional Çlirimtar i Jugosllavisë (AVNOJ) kishte shpallur federatën. Para 200 gazetarëve, më shumë se gjysma gazetarë të huaj, ai tha për trazirat në Prishtinë se një pjesë e vogël e rinisë kanë thyer disa vitrina, ashtu siç bëjnë edhe në Perëndim e gati kudo tjetër, pra s’ka pse dramatizohen. Megjithatë, nuk la pa përmendur shkarazi se populli nuk do të lejojë disa elementë të pengojnë zhvillimin, domethënë të shkatërrojnë bashkim-vëllazërimin në Krahinën Autonome.²¹ Gjithsesi, Kryetari i Jugosllavisë nuk ishte i qetë. Pas kthimit nga Jajca ai i ka kërkuar kryetarit të LK të Krahinës, Veli Deva, masa të rrepta që “askush të mos luajë me unitetin tonë, me federatën e popujve tanë”, duke shtuar se megjithatë “gjërat në publik nuk duhet t’i dramatizojmë, pikërisht për shkak të opinionit të jashtëm”.²²

Sipas këtyre porosive, organet drejtuese të partisë, si në Kosovë, ashtu edhe në Republikën e Maqedonisë u përfshinë në analiza të ashpra për të identifikuar armiqtë e brendshëm dhe çdo ndikim nga jashtë që kërcënonte federatën. Gjashtë muaj pas demonstratave, thuhet se, ishin arrestuar 110 persona, shumica studentë, mësues, por edhe punëtorë e zanatçinj. Kishte dhjetëra të përjashtuar nga shkolla, nga partia. 77 vetë morën dënime të lehta. Në gjyqin e Prishtinës u dënuan 9 vetë, katër prej tyre me nga pesë vjet burg të rëndë dhe tre të tjerë me nga tre vjet.

¹⁹ Po aty, f. 114.

²⁰ “Krahina Autonome duhet t’i gëzojë të gjitha të drejtat që i takojnë”, *Rilindja*, Prishtinë, 4 nëntor 1968.

²¹ *AMPJ*, V. 1968, D. 360, fl. 122-129. Radiogram i deshifruar nr. 1203-1207, datë 3-4 dhjetor 1968, i legatës së RPSH në Beograd për Ministrinë e Jashtme në Tiranë; shih edhe gazetën *Rilindja*, Prishtinë, 1 dhjetor 1968.

²² “Mbledhja e tretë plenare e Komitetit Krahinor të LK të Kosovës dhe Metohisë”, datë 9 dhjetor 1968, në *Demonstratat e vitit 1968 në Arkivin e Kosovës*, përgatitur nga Ethem Çeku, Prishtinë: “Brezi 81”, 2009, f. 177.

Motivacioni: përhapje e propagandës armiqësore, thirrje kundër-kushtetuese për shkatërrim të rendit shtetëror, të vëllazërimit dhe unitetit të popujve të Jugosllavisë. Hetimet vazhdojnë, thuhet në material.²³ Edhe më e ashpër është fryma e goditjes së separatizmit nga autoritetet maqedonase. Në të gjitha analizat, fjalimet publike u fol për qëllime bashkimi të shqiptarëve të Kosovës e Maqedonisë në një republikë të përbashkët, e cila do të ishte “kryeurë taktike në rrugën kah qëllimi kryesor – bashkimin e Shqipërisë etnike.”²⁴ Për njëmbëdhjetë organizatorët e demonstratës në Tetovë, Gjykata e Qarkut Shkup dha dënime të ashpra, deri në shtatë vjet burg të rëndë.²⁵

Me që motiv për demonstratat në Kosovë e Maqedoni është pabarazia etnike, motiv që mungon në demonstratat e tjera të atij viti në Evropë; me që rrethanat që nxitën ose favorizuan këto demonstrata janë a) klima e përgjithshme e revoltës që përfshiu Perëndimin e Lindjen, b) reformat liberalizuese në ekonomi dhe masat kundër hegjemonizmit në marrëdhëniet ndëretnike, dhe c) hapja e diskutimeve publike për ndryshimet kushtetuese; mendimi shkon edhe tek zhvillimet në Çekosllovakia nëse ishin ose jo nxitje për shqiptarët e Kosovës dhe të Maqedonisë. Të gjithë ata që e kanë trajtuar këtë temë, nuk gjejnë lidhje midis tyre. Trazirat në Kosovë filluan kur ‘Pranvera e Pragës’ ishte shtypur me tanke. Deri atëherë rinia çekosllovake ishte bërë frymëzim për botën komuniste. Reformat e udhëheqësit çekoslllovak qenë pritur me simpati nga Tito, i cili i përshëndeti, ashtu siç edhe e denoncoi pushtimin nga ushtritë e pesë vendeve të Paktit të Varshavës. Pushtimin e Çekosllovakisë, Jugosllavia e përcolli me manifestime protestash, të cilat ishin të drejtuara nga LKJ. Por, nga koha kur u mbajtën manifestimet kishin kaluar muaj, dhe për më tepër, motivet që nxitën protestuesit në Prishtinë ishin të tjera nga ngjarjet e fundit në Pragë.

Gjithsesi, duke ndjekur zhvillimet e mëvonshme, ndoshta do t’ia vlen të një hollësi në përfaqëset midis Pragës dhe Prishtinës, hedhur në rrjetin *on line* nga *Akordet e Kosovës*. Në Pragë, në janar 1969, studenti çek, Jan Palach, do të kthehej në simbol me vetëflirimin e tij. Në Prishtinë, brezi i viteve ’60-’70 e ka ende në memorie një koncert të një

²³ AMPJ, V. 1969, D. 21, *Buletin informativ*, nr. 28, datë 28 maj 1969.

²⁴ Marijana Stamoja, *Faktori shqiptar në Republikën Socialiste të Maqedonisë, 1945-1981*, European Union: 2014, f. 107.

²⁵ Selatin Novosella, *Demonstratat e gjashtëdhjetetës*, vëll. 2, dokumente, Prishtinë: Shoqata e të Burgosurve Politikë të Kosovës, 2008, f. 160.

kantautori shqiptar që u mbajt në sallën e madhe të Fakultetit Filozofik. Në atë koncert poeti, këngëtari Jusuf Gërvalla solli një këngë që ngriti peshë publikun. Ishte shtator 1970 dhe kënga quhej “Baladë për Jan Palach”. Është thënë se akti i Palach, më tepër se protestë kundër pushtimit, ishte protestë kundër demoralizimit të shoqërisë, pajtimit me të keqen. Një gjendje e përafërt po ndodhte edhe me Kosovën. Demonstratat qenë shuar. Ato i kishte dënuar edhe vetë udhëheqja krahinore e Kosovës. Në jetën publike që rikthyer kontrolli i shërbimit të fshehtë serb. Duket se djaloshi Gërvalla tentoi ta nxirrte publikun nga përgjumja, duke dhënë nga vetja një Jan Palach të fshehur, çka zgjoi aq shumë emocione.

Prapëseprapë, Kosova vijoi apatinë e vet, ashtu sikundër Praga që ambientuar me pushtimin. Nga Tirana drejt Pragës u bënë përpjekje për të mbështetur atje organizatat ilegale marksiste-leniniste, praktikë që Partia e Punës e Shqipërisë po e aplikonte me shumë zell në Evropë dhe jashtë saj.²⁶ Është koha kur në Shqipëri, Hoxha ishte dhënë pas idesë delirante të përmbysjeve revolucionare të partive revizioniste. Kuptohet, në Çekosllovakia, as këto grupe, dhe as përpjekjet nga Tirana, nuk patën sukses. Ndryshe ndodhi me organizatat ilegale të shqiptarëve në Kosovë, në Jugosllavi dhe jashtë saj, të cilat u gjallëruan pas shtypjes së protestave më 1968, dhe ku, frymëzimi nga Tirana që i pranishëm. Erdhi koha që në krye të njërës prej këtyre organizatave më të njohura të ishte ai, Jusuf Gërvalla, djaloshi i dikurshëm i baladës për Jan Palach; deri sa më 17 janar 1982, në Untergruppenbach (Gjermani) Jusuf Gërvalla, bashkë me të vëllanë, Bardhosh Gërvalla dhe Kadri Zekën, një tjetër veprimtar ilegal, u gjendën të vrarë. Autoritetet gjermane nuk janë shprehur për këto vrasje. Shtypi bëri përgjegjës shërbimin e fshehtë jugosllav UDB-a.²⁷

Në analizat partiake të pasprotestave, në Prishtinë e Tetovë, është lënë e nënkuptuar një nxitje nga Shqipëria. Sot, kur kemi në dorë të dhënat e nevojshme dokumentare, është krejt e qartë se më 1968, Tirana nuk kishte gisht në protestat në Kosovë, e aq më pak, në Maqedoni. Madje, pas rënies së Rankoviçit, Enver Hoxha i ka pritur me një farë

²⁶ AMPJ, V. 1968, D. 25. Radiogram i deshifruar nr. 2607, datë 1 shtator 1968, i MPJ për ambasadën e RPSH në Pragë. Në këtë radiogram i kërkohet ambasadës shqiptare raport i hollësishëm për organizatat ilegale që janë krijuar në Çekosllovakia, për programet, veprimtaritë dhe forcën e tyre.

²⁷ *Der Spiegel*, “Das ganze sieht nach Hinrichtung aus” [“E gjitha kjo duket si ekzekutim”], 25 janar 1982.

shqetësimi lajmet që bënin fjalë për një republikë të Kosovës, duke i dhënë një interpretim se ajo mund të ishte një krijesë e titistëve e ku mund të mblidheshin brenda saj ballistë e kundërshtarë të tjerë të kohës së Luftës së Dytë Botërore, që gjendeshin në Evropë dhe Shtetet e Bashkuara.²⁸ Ndoshta, Hoxha mund të ketë fantazuar për një *Rollback* të dytë dhe është e njohur, që në raportet me jugosllavët, Hoxha e vuante një patologji mosbesimi.

Por të dhënat që ruhen në Arkivin e Ministrisë së Punëve të Jashtme të Shqipërisë, provojnë se qëndrimi i Shqipërisë nuk ka ndryshuar aspak, edhe dy vjet më vonë, pra më 1968. Më 19 shtator 1968, kur Kosova vlonte nga ideja e republikës, legata shqiptare në Beograd i ka kërkuar Tiranës udhëzime çfarë duhej të bënte me shqiptarët e Kosovës, të cilët mendonin se Shqipëria mund të jepte ndihmë që Kosova të shpallej republikë, sepse “vetëm me krijimin e republikës krijohen kushte për bashkim me mëmën Shqipëri”.²⁹ Këtu poshtë, me pak shkurtime, është raporti i drejtorisë përkatëse me përgjigjen për çështjen që ngre përfaqësia shqiptare në Beograd:

“Më 19 shtator 1968 ambasada shqiptare në Beograd i ka kërkuar Ministrisë së Punëve të Jashtme udhëzime si t’u përgjigjen kosovarëve që kërkojnë ndihmë nga Shqipëria që ata të shkëputen nga Jugosllavia dhe të bashkohen me Shqipërinë ... Ne mendojmë se shokët e përfaqësuesit nuk kanë të drejtë që u besojnë apriori kosovarëve, që u paraqiten me kërkesa të kësaj natyre. Prandaj mendojmë t’u japim këto porosi:

1) Të jenë vigjilentë ndaj atyre që ngrenë të tilla kërkesa

2) ... zgjidhjen e problemit të Kosovës nuk e ndajmë nga zgjidhja e problemit të përgjithshëm të Jugosllavisë, d.m.th nga rrëzimi i klikës së Titos dhe ardhja në fuqi e një udhëheqjeje marksiste-leniniste në vend të saj, e cila në kuadrin e çështjeve nacionale në Jugosllavi, do t’i jepte popullsisë shqiptare të drejtën për vetëvendosje me plebishit. Në këtë kuptim popullsia shqiptare duhet të mbështesë forcat eventuale marksiste-leniniste jugosllave për realizimin e synimeve të tyre.

3) Qëndrimi ynë për çështjen e Kosovës në këtë situatë nuk ka ndryshuar. Ne këshillojmë kosovarët që të luftojnë si edhe deri më tani për të fituar sa

²⁸ “Popujt dhe marksistë-leninistët revolucionarë jugosllavë duhet të luftojnë”, më 1 gusht 1966, në Enver Hoxha, *Ditar për çështje ndërkombëtare (1966-1967)*, vëll. 4, Tiranë: Instituti i Studimeve Marksiste-Leniniste, 1982, f. 147.

²⁹ *AMPJ*, V. 1968, D. 360/1, fl. 89. Radiogram i deshifruar nr. 920-925, datë 19-20 shtator 1968, i legatës së RPSH në Beograd për Ministrinë e Jashtme në Tiranë.

më shumë të drejta në të gjitha drejtimet, duke synuar që të arrijnë të gëzojnë po ato të drejta që gëzojnë edhe kombësitë e tjera në Jugosllavi.

4) Për sa i përket çështjes nëse jemi për republikë apo për krahinë autonome, ju i keni udhëzimet. Përsërisim se ne nuk jemi për krijimin e republikës, sepse kjo nuk do ta zgjidhte problemin. Ai do të zgjidhet vetëm ashtu sikurse thuhet në pikën 2 ...”³⁰

Në mbyllje të këtyre citimeve, është e qartë se Tirana zyrtare nuk i ka dashur protestat në Kosovë dhe prandaj ajo nuk njoftoi as qytetarët e vet kur ato ndodhën. Duket se ky qëndrim i Tiranës u ka ardhur për shtat edhe drejtuesve politikë në Kosovë, të cilët atë kohë nuk ishin të përgatitur dhe as i dëshironin demonstratat e shqiptarëve me kërkesa për republikë e aq më pak për vetëvendosje. Këtë gjë, dy vite më pas, Fadil Hoxha, anëtar i Byrosë Ekzekutive në Lidhjen Komuniste të Jugosllavisë, ia ka përcjellë Enver Hoxhës përmes të Ngarkuarit me Punë në legatën shqiptare në Beograd, kur thotë se “Heshtja e Shqipërisë që një ndihmë e madhe për ne e sidomos për ne kuadrot kosovarë”. Në atë bisedë, Fadil Hoxha e ka shprehur ngultas mendimin e vet: “Unë koshiencërisht kam punuar që Kosova të mos shpallet republikë, sepse njoh vetëm një republikë të shqiptarëve dhe ajo është Republika Popullore e Shqipërisë.”³¹ Pas këtij mesazhi, në shtator 1970, Enver Hoxha e ka pritur diplomatit shqiptar në Beograd dhe i ka kërkuar të dhëna më të hollësishme për bisedën me Fadil Hoxhën. Në fund i ka dhënë edhe një tekst të shkruar, me porosinë që t’ia përcillte gojarisht Fadil Hoxhës. Mesazhi përmbante një varg çështjesh, por lidhur me Kosovën, Enver Hoxha konfirmon si më poshtë: “Mendimin tuaj për të mos pranuar krijimin e një republike të dytë shqiptare ne e quajmë të drejtë. Ky është qëndrim i drejtë e patriotik. Një qëndrim të kundërt Republika Popullore e Shqipërisë nuk do ta pranojë. Ne jemi dakord me mendimin tuaj se ka vetëm një Republikë Popullore të Shqipërisë.”³² Në fakt, takimi i të Ngarkuarit me Punë në Beograd me Fadil Hoxhën është bërë mjaft vonë, në mes të majit 1971, ndoshta për shkak se formulimet për Titon kanë

³⁰ *Po aty*, V. 1968, D. 360/3, fl. 249-250. Drejtoria IV: “Informacion ditor i datës 30 shtator 1968”.

³¹ *Po aty*, V. 1970, D. B/1-3, fl. 67. Raport i të Ngarkuarit me Punë a.i. të RPSH në Beograd, Lik Seiti, për Ministrinë e Punëve të Jashtme, më 17 qershor 1970.

³² *AQSH*, F. 10/AP, L. 1, V. 1970, D. 387/1. Takim i Enver Hoxhës me të Ngarkuarin me Punë a.i. në Beograd, Lik Seiti, më 19 shtator 1970.

qenë pjesa më delikate e këtij mesazhi. Në prill Ramiz Alia i dha një tekst tjetër Lik Seitit, por pjesa për Kosovën mbeti e paprekur.³³ Për takimin midis Fadil Hoxhës dhe Lik Seitit, më 14 maj 1971, kanë dhënë raportet e tyre edhe njëri edhe tjetri. Takimi nuk u bë si “rastësisht” në ndonjë pritje diplomatike e as gjatë një vizite në shtëpi, siç ishte sugjeruar nga Tirana, por në kabinetin e F. Hoxhës, përmes zyrës së protokollit të Sekretariatit të Punëve të Jashtme të Jugosllavisë. Në raportet nuk flitet për të tjerë të pranishëm në bisedë. Duket se biseda është dominuar nga nevoja për raporte më të afërta midis dy vendeve.³⁴

Megjithatë, në opinionin tim, edhe pse Shqipëria nuk ishte e implikuar, protestat kishin frymëzim nga Shqipëria. Kjo lidhet me kohën kur midis Tiranës dhe Prishtinës u vunë urat e shkëmbimeve kulturore. Më 2 dhjetor 1967 në Tiranë erdhën katër pedagogë dhe punonjës të njohur shkencorë* nga Prishtina, të cilët kërkuan që pedagogë nga Shqipëria të mbanin leksione dhe të merrnin pjesë në konferenca shkencore. “Keni për të parë si do të ju presë rinia, si do të mblidhen nga anë e anës, thanë ata. Dërgoni më të zotët, të shohin serbët që ne jemi komb i përparuar.”³⁵ Kishin të drejtë. Më 1968 ishte viti i 500 vjetorit të vdekjes së Skënderbeut dhe në Prishtinë u mbajt një simpozium shkencor. Në të mori pjesë edhe një grup studiuesish nga Tirana. Ata u pritën me ovacione, duke e kthyer simpoziumin në një ngjarje festive. Një studiues nga Gjermania u tha profesorëve nga Shqipëria: “Këtu qenka vullkan!”³⁶

³³ *Po aty*, fl. 32. Shih variantin e mesazhit që Ramiz Alia i ka dhënë Lik Seitit, më 9 prill 1971.

³⁴ *AMPJ*, Fondi i Përhershëm, Kosova, V. 1971, D. 641/1. Raport i të Ngarkuarit me Punë në Beograd për takimin e tij me Fadil Hoxhën, 15 maj 1971; shih edhe: *Arhiv Centralnog Komiteta Saveza Komunistica Jugoslavije*, II, 1/1 – 415, br. listova 7, datum 1971.V.14, Informacija o razgovoru Fadilja Hodže... sa Lik Seitom..., 14 maja 1971 godine.

** Profesorët që erdhën nga Prishtina në Tiranë dhe që bënë disa takime me drejtues, pedagogë e studiues të Universitetit Shtetëror të Tiranës, ishin: prof. Idriz Ajeti, prof. Fehmi Agani, prof. Dervish Rozhaja dhe prof. Syrja Pupovci.

³⁵ *AQSH*, F. 14/AP-Strukturë, V. 1967, D. 255/1, fl. 2-15. “Relacion i Universitetit Shtetëror të Tiranës drejtuar sektorit të Jashtëm në KQ të PPSH, për bisedimet me delegacionin e pedagogëve dhe të punonjësve shkencorë nga Kosova”, më 28.12.1967.

³⁶ *AMPJ*, V. 1968, D. 360/2, fl. 298. Radiogram i deshifruar nr. 413-417, datë 14 maj 1968, i legatës së RPSH në Beograd për MPJ, në Tiranë.

Pasi sollëm një varg regjistrimesh arkivore se si u pritën demonstratat e shqiptarëve më 1968 nga Beogradi dhe Tirana zyrtare, si dhe nga faktori politik i Prishtinës, është vendi të shprehemi edhe si u pritën në plan ndërkombëtar këto ngjarje. Sigurisht, agjencitë e huaja të lajmeve, disa gazeta dhanë njoftimet e tyre, qoftë dhe duke iu referuar Titos në Jajcë. Ndërsa, opinioni zyrtar ndërkombëtar pothuajse heshti për ngjarjet. Madje, kjo mbështetje mungoi jo vetëm më 1968, por edhe më 1981 dhe, për paradoks, edhe më 1989. Kjo lidhet me raportet etnike në Ballkan, të cilat kanë qenë e mbeten problematike. Jugosllavia ka qenë tipike në këtë plan. Në këtë qerthull etnish ish Jugosllavia ishte një hapësirë midis Lindjes e Perëndimit, ku takoheshin interesa, më shumë interesa politike, si zonë koniunkturash dhe kompromisesh. Për Bllokun Lindor, Jugosllavia mbeti problemi më kryesor, shembulli që nuk duhej ndjekur. Për Perëndimin, modeli si mund të krijohet një zonë erozioni ndaj Bllokut Sovjetik, pa qenë nevoja e përmbysjeve të dhunshme. Në dy Luftërat Botërore, mbretëria dhe federata jugosllave u krijuan pothuaj fshehurazi. Por edhe midis dy Luftërave, edhe pas Luftës së Dytë, bota ia kishte frikën shembjes, shpërbërjes. Prandaj të dy blloqet kanë qenë veçanërisht të kujdesshëm për të mos inkurajuar asnjë lëvizje separatiste. Jugosllavët e kanë ditur këtë dhe kanë abuzuar shumë me këtë fakt. Kjo është arsyeja më kryesore, pse faktori ndërkombëtar e shpërfilli çështjen e Kosovës. Për të mos thënë se, reminishencat e shpërfilljes i kemi sot e kësaj dite.

Pengesa tjetër që ka të bëjë me të drejtën ndërkombëtare dhe me debatin se kujt i takon e drejta e vetëvendosjes dhe **Kur** e **Si** mund të zbatohet ajo, kjo është dytësore dhe për më tepër gjithnjë e diskutueshme dhe me doza subjektivizmi. Faktori ndërkombëtar, e përfshiu në agjendën e vet çështjen e shqiptarëve të Kosovës, vetëm kur regjimi i Millosheviç-it i tejkaloi zullumet, duke rrënuar të drejtat e fituara, autonominë dhe institucionet. Atëherë statusi i Kosovës u bë pjesë e lëvizjes për demokraci dhe të drejtat e njeriut. E përsëri, mbetem e bindur se procesi do të kishte vijuar *tërhiq e mos e këput*, sikur Millosheviç të mos bënte këtë radhë atë që pakkush e besonte, provokoi luftëra të përgjakshme, në Bosnjë, Kroaci e së fundmi në atë që e quante djepin e vet, Kosovën.

Duke trajtuar lëvizjet e 68-s, për ngjashmëritë dhe pangjashmëritë me njëra-tjetrën, do të përmend edhe dy lëvizje, me interes për tipologjitë e tyre. Fjala është për Revolucionin Kulturor Proletar në Kinë dhe për lëvizjet masive revolucionare në Shqipëri. Studiuesit dhe politologët që

kanë trajtuar lëvizjet e gjysmës së dytë të viteve '60, në pjesën më të madhe, nuk kanë lënë jashtë ngjarjet në Kinë. Nuk jam e qartë për kriteret e përdorura, por të vetmen ngjashmëri që unë shoh me lëvizjet simotra, është se edhe atje, si kudo gjetkë, të rinjtë ishin në qendër të revolucionit kinez. Një ngjashmëri tjetër, mund ta vërejmë në faktin, se lëvizjet, në pjesën më të madhe u radikalizuan, duke u kontrolluar nga grupe ekstremiste. Për këtë shkak demonstratat në mjaft raste u kthyen në të dhunshme. Në Kinë, gardistët e kuq qenë grupe ekstremisht të indoktrinuar, deri atje sa u bënë pjesë e lëvizjeve të përgjakshme. Por, Revolucioni Kulturor Kinez ka deri diku të ngjashmin e vet, atë që në Shqipëri është quajtur Revolucion Ideologjik, si pjesë e të cilit janë regjistruar nisma ideologjike, kulturore, politike etj., dhe ku u përfshinë mijëra njerëz, sidomos të rinj.

Të dy këto raste, si ai kinez, ashtu edhe ai shqiptar janë të veçantë. Në të dy këto vende, edhe reformat edhe lëvizjet popullore, sidomos të rinisë, janë projektuar nga lart. Në Kinë, Mao filloi më 1966 Revolucionin Kulturor, duke mobilizuar gardistët e kuq për të përmbysur gardën e vjetër në parti dhe përhapur revolucionin.³⁷ Në dukje, këto ishin lëvizje spontane të punëtorëve, ushtarëve, studentëve etj., por në fakt funksiononte një regji veprimesh, që nga manifestimet në Tienanmen e deri te turmat linçuese kundër atyre, “që kishin marrë rrugën kapitaliste”. Në fakt, këta miliona njerëz dilnin shpesh jashtë kontrollit, por edhe kjo duket se qe parashikuar dhe mbahej nën vëzhgim.

Lëvizjet që realizoheshin poshtë, por të projektuara dhe të kontrolluara nga lart, ishin një tipar dhe për Shqipërinë komuniste. Kjo nuk është e vështirë në shoqëritë e kontrolluara. Lajmëtarja e parë për këto lëvizje ishte një “Letër e Hapur,” 4 mars 1966, që Komiteti Qendror i PPSH u dërgonte gjithë punonjësve, ushtarëve dhe oficerëve.³⁸ Në pamje të parë Letra është ftesë drejtuar qytetarëve për pjesëmarrje në kontrollin e qeverisjes, por në fakt është hapi i radhës që partia të merrte në kontroll gjithë shoqërinë. Është koha kur marrëdhëniet me Pekinin janë intensifikuar. Një program ambicioz për industrializimin do të zbatohej falë ndihmës kineze. Vitet 1966-70 janë vitet kur bilancet e të ardhurave, bilancet valutore, GDP, përgjithësisht bilancet ekonomike

³⁷ Ten Rong, *Ten Hsiao Pin dhe Revolucioni Kulturor*, Tiranë: Shtëpia Botuese “55”, 2012, f. 43.

³⁸ AQSH, F. 14/AP-OU [Organet udhëheqëse], V. 1966, D. 2, fl. 34-62. “Letër e Hapur e Komitetit Qendror të PPSH”, 4 mars 1966.

janë më të mirat e mbërritura deri atëherë, por që më vonë morën përsëri kurbë zbritëse.

Në këto kushte sigurie për ekonominë, Enver Hoxhës iu desh të mbante disa fjalime, me të cilat njoftonte “betejat” e ardhshme. Atë kohë zotëroi kudo një terminologji luftime - luftë kundër burokratizmit, luftë kundër zakoneve të vjetra, luftë kundër shfaqjeve të huaja borgjeze-revizioniste etj. Në mënyrën e zbatimit do të mbizotëronin grumbullimet masive të njerëzve, turma, brigada vullnetare rinie, nxënës e studentë, kolektiva punëtorësh, grash, veteranë luftime, mitingje solidarizuese ose demaskuese, sipas rastit. Për Hoxhën ideja e mbështetjes popullore ishte e rëndësishme. Ai u përpoq ta sigurojë këtë dhe në mjaft raste ia arriti.

Midis lëvizjeve masive në Kinë dhe atyre në Shqipëri ka shumë përjasje dhe është e dukshme që modeli kinez ka qenë i pranishëm. Këto lëvizje janë realizuar në kushte të ngjashme, por jo gjithmonë për qëllime të njëjta. Një fakt. “Kur Mao Ce Duni, më 5 gusht 1966, lëshoi *dàzibào*-n e tij ‘goditni shtabin!’ u kuptua se gardistët e kuq ishin thirrur për të spastruar partinë. Sepse revolucioni u përdor, kur Mao ishte në ditë të vështira, pas dështimit të Hopit të Madh Përpara. Në Shqipëri ‘lëvizjet revolucionare’ nuk kishin qëllime spastruese, por qëllime afirmuese të rolit drejtues e kontrollues të partisë. Sepse, Hoxha nuk ishte në ditët më të vështira të tij dhe ky ishte rasti më i mirë për t’i përdorur këto lëvizje ‘popullore’ si *demonstrime show* që e ngrinin më tej kultin e partisë dhe kultin e vetvetes.”³⁹

Kësisoj, në se ka një vend në botën komuniste, ku lëvizjet e 67-68-s, si demonstratat e Kosovës, apo ditët në lulëzim të Pragës, nuk u ndjenë fare, ky vend ishte Shqipëria. Dhe kjo erdhi, sa për shkak të izolimit të plotë, aq edhe falë skenarit të demonstrimeve populiste, ku u tërhoqën dhe u përfshinë masa të gjera njerëzish, e sidomos të rinjsh.

Përfundime

1. Revoltat e gjysmës së dytë të viteve ’60 shprehin një stad të caktuar të shoqërisë në përgjithësi dhe të shoqërive në shtete të veçanta. Çdo pikëmbërritje e shoqërisë nënkupton disa tregues themelorë, që lidhen me shkallën e arritjeve ekonomike, kulturore, si dhe kulturën e

³⁹ Ana Lalaj, “1968: The Prague Spring and the Albanian ‘Castle’”, in *Eastern Europe in 1968, Responses to the Prague Spring and Warsaw Pact Invasion*, eds., Kevin McDermont and Matthew Stibbe, Palgrave Macmillan, 2018, p. 242.

qeverisjeve. Parë në këtë prizëm, burimet e pakënaqësive dhe shkaqet për revolta kanë qenë dhe mbeten të shumta dhe sidomos mjaft komplekse. Revoltat kudo, në Lindje e në Perëndim, u drejtuan kundër autoritetit, duke nënkuptuar cilësinë e menaxhimit në kompanitë e prodhimit ose të shërbimeve, mësimdhënien në shkolla, kushtet e studimit në fakultete etj. Protestat kanë treguar se kjo shkallë revolte përparon deri në nivelet më të larta të qeverisjes. Është koha kur qeveritë janë bërë më opake*, duke e kërkuar stabilitetin jashtë konsensusit të brendshëm, gjë që ka ndaluar progresin. Revoltat kanë ardhur edhe nga një farë krize identiteti të rinisë në kushtet e reja të zhvillimit, në bumet arsimore, por me pasiguri punësimi, në zgjerimin e hendekut kulturor midis brezave etj. Në këtë hartë burimesh janë veçoritë lokale ato që i japin fytyrën çdo manifestimi revolte.

2. Revoltat treguan se të rinjtë ishin të aftë të artikulonin pakënaqësitë dhe kërkesat e tyre, por nuk paraqitën programe zhvillimi. Ata nuk kishin qëllim të ofronin alternativa qeverisjeje, por rrallë ishin sugjerues. Përpjekja për t'u kapur nga grupe politike vetëm se i radikalizoi revoltat, duke e ulur besueshmërinë. Dobësitë e përmendura bënë që në përgjithësi ndryshimet në shoqërinë e fundviteve '60 të ishin të pandjeshme. Ka një ndryshim të njohur në administrimin e protestave në shoqëritë demokratike dhe ato totalitare. Për të parat, protestat janë njëri nga mjetet për të shprehur vullnete individuale dhe kolektive, pra shkallë demokracie. Për të dytat ato janë destruktive, armiqësore, antishtet dhe antipopullore. Të parat bëjnë kujdes për t'i *administruar* dhe madje për t'i mbrojtur sa nuk janë të dhunshme. Të dytat marrin *masa shtypëse që në fillim*. Në të gjitha vendet e Lindjes, ato u shtypën. Shembulli më ekstrem i dhunës është ndërhyrja me ushtri e Paktit të Varshavës në Çekosllovakia dhe goditja e studentëve me armë. Ndërkohë, në Paris, megjithëse demonstratat ishin të dhunshme, masakra u arrit të shmangej falë dhe ndërhyrjes së strukturave drejtuese të pushtetit në metropol.

3. Nga të gjitha demonstratat e vitit 1968, demonstratat në Prishtinë e Tetovë ishin të vetmet që u mbajtën për të drejta kombëtare. Për Jugosllavinë kjo ishte pikë e nxehtë. Shqiptarët u përpoqën me këtë rast të marrin maksimalen, duke shfrytëzuar një moment në favor të tyre, ndryshimet kushtetuese në Federatë. Ndërsa serbët dhe udhëheqës të tjerë

* *opake* - jo transparente.

në federatë i paraqitën kërkesat e shqiptarëve si destabilizuese, separatiste, shpërbërëse për Jugosllavinë, e kësaj armiqësore. Është e diskutueshme nëse shqiptarët luajtën taktikisht drejt ose jo. Megjithatë për ta ishte rasti më ideal që u kishte ardhur ndonjëherë. Gjithsesi, ndryshimet kushtetuese të propozuara nga komisioni krahinor ishin arritje e rëndësishme. Ato nuk u penguan nga demonstratat e shqiptarëve, por edhe nuk u mundësuan për shkak të tyre. Ky ishte një projekt i ekuilibruar që Tito vlerësoi se i shërbente unitetit në federatë në rrethanat e atëhershme. Mbajtja dhe më tej e politikave shtrënguese për shqiptarët, dhe jo vetëm për ta, do të ishte gjithsesi kërcënuese. Shembulli i '89-s është treguesi si mund të prodhohet dhunë e shfarosje. Për t'u kthyer tek përjasjet me revoltat e tjera, demonstratat në Kosovë vërtet nuk morën pëlqim nga autoritetet e të gjitha niveleve, por janë të vetmet që ruajtën thelbin e tyre dhe kërkesat u përsëritën në një shkallë më të gjerë në vitet '81 e '89.

4. Kërkesat e demonstruesve shqiptarë nuk u pritën mirë jo vetëm në organet federative, republikane e krahinore, por as në Tiranë. Arsyeja e parë është se udhëheqja e Tiranës u gjend e papërgatitur dhe mund të arsyetohet si telash i shtuar me Jugosllavinë, në rrethanat kur sapo ishte denoncuar Pakti i Varshavës. Mbi të gjitha, Hoxha u trembej trazirave në kamp, që nuk dihej se ku mund të arrinin. Për këtë arsye, opinionimi publik i Shqipërisë u mbajt i painformuar për demonstratat e Kosovës. Ashtu siç u mbajt i painformuar edhe në rastin e protestave të studentëve të Pragës, të Varshavës etj. Ndryshe ndodhi me protestat në Paris, kur i ka komentuar në një takim në Mirditë, e ndryshe veprroi në rastin e çekëve, të cilët i quan huliganë. Rastin e Parisit ai e sheh si dukuri të kalbëzimit të sistemit, ndërsa rastin e vendeve të Bllokut si kërcënim në shtëpi. Në të vërtetë, frika për shpërbërjen e sistemit u manifestua edhe tek të tjerë, Brezhnjevi, Gomulka, Zhivkovi etj. Kjo situatë sugjeronte taktikë tjetër. Gjithë vitet '60, Hoxha ishte grindur me të gjithë, por ajo kishte qenë luftë kupolash. Njerëzit, në vendin e tij apo ngado në botë, gjithnjë e më pak merakoseshin se dikush mbronte e të tjerë shanin Stalinin, Hrushovin, a cilindo tjetër. Hoxha po kuptonte se kjo nuk ishte luftë për të mbrojtur Marks-in, por ishte luftë për të mbrojtur kokën.

Në ngjarjet e 68-ës, dy janë më pikantet, trazirat e Parisit dhe Pranvera e Pragës. Kjo e dyta na vjen në dy pamje: a) si eksperiment reformues brenda një shoqërie dhe partie komuniste, b) si ndërhyrje për ndërprerjen e eksperimentit. Zhvillimet nga prilli deri në gusht 1968, në

Pragë u konsideruan si më shpresëdhënëset në Bllokun komunist. Por Brezhnjevi dhe të tjerë i panë si rrezik, prandaj ai kërkoi mbrojtjen e Bllokut, qoftë edhe me armë. Në perceptimin e tij, reformat në Çekosllovakia e rrezikonin sistemin. Ndoshta kishte të drejtë. Ndërhyrja e Brezhnjevit me ushtri i shtyu jetën komunizmit edhe për njëzet vjet të tjerë, kanë vërejtur studiuesit. Më 1989, pas njëzet vjetësh, ngjarjet u rikthyen, jo krejt identike, po thelbësisht të afërta. Eksperimenti që ndërprerë, po kishte mbetur embrioni.

S u m m a r y

SIMILARITIES AND DIFFERENCES IN THE MOVEMENTS OF 1968

(A comparative study of the Albanians' movements in Prishtina, Tetovo and Albania)

The year 1968 marked a time of great protests, when the participants, mainly youngsters, students, pupils, but also intellectuals and workers rose up for their right of free speech, against the Vietnam war, asked for higher wages and for a human-face socialism. Although the protests took place within the same year and were similar to one another, they also had several differences. Their similarities and differences resulted from the local circumstances in the universities, factories, regions and countries where they were organized. However, all these movements represented opposition to authority which did not match the new cultural, moral and economic standards that were created or intended to be reached. All the different groups of the society found themselves in an identity crisis. Anyway, these movements lacked any political platform and as a consequence no government fell because of the protests.

With regards to the Albanians of Kosovo and Macedonia, the demands of the protesters had a nationalistic character and the main slogan was *Kosovo a republic*. These demands were welcomed neither in Kosovo nor in Tirana. Enver Hoxha was suspicious that the demands for the establishment of the Republic of Kosovo were incited by the Albanian emigrants in the West, or by Tito himself who could use them as an argument against the Peoples' Republic of Albania. Therefore, Hoxha did not make any public statements concerning the protests but sent messages to the Kosovar leadership that he did not approve of them.

As for the movements in the PR of Albania, along with the ones in the PR of China, specific interesting features need to be emphasized. They were concurrent with the movements of 1968 in the East and the West but differed meaningfully from them because they were centrally organized and controlled and aimed at fostering the communist rule in these countries and brought about substantial moral and social deviations to the respective societies.